

Klasifikimi me përcaktuese lëndore

Biblioteka përdor dy tezaurë me përcaktuese lëndore të përkthyer nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë që janë version i shkurtuar i Përcaktueseve lëndore të Bibliotekës së Kongresit, ShBA.

Përcaktueset lëndore janë pjesë e përshkrimit dhe e kontrollit bibliografik. Ato mundësojnë organizimin e njësive bibliografike sipas një lëmi apo lëmenjve për të cilët bën fjalë vepra. Ndryshe nga Klasifikimi Universal Decimal, i cili përdor shifra në përcaktimin e lëmit, përcaktueset lëndore janë emërtime me fjalë dhe shprehin në mënyrë të drejtpërdrejtë funksionin e tyre. Megjithatë, këto përcaktuese apo emërtime janë të njësuar dhe të standardizuara duke u dhënë mundësi përdoruesve, të cilët nuk mund të gjejnë materialin e tyre përmes ‘titullit’ apo ‘autorit’, etj., të mund ta gjejnë atë përmes përcaktueseve.

Për të ruajtur këtë njësueshmëri apo standardizimin e përcaktuesve, Bibliotekat përpiqen që të përdorin terminologjinë e njëjtë gjatë caktimit të përcaktuesve lëndore në njësitë bibliografike. Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës përdor formatin MARC21 për t’i strukturuar dhe organizuar përcaktueset lëndore.

Përcaktueset lëndore janë një listë e hollësishme me terma të njësuar të botuar, të cilët japin informacione shtesë nëse përcaktuesja është “subjekt i gjerë” ‘SGJ’, apo “subjekt i ngushtë” ‘SN’, si dhe mund të japin sugjerime për përdorimin e një termi tjetër përmes konstruktit “përdor për” ‘PP’. Ky lloj ndërtimi i termave në sistemet e sotme kompjuterike mundëson që termat të lidhen ndërmjet veti për t’i dhënë përdoruesit një mjet të fuqishëm të kërkimit të informacionit. Shembujt e mëposhtëm paraqesin strukturën dhe funksionet e termave të përdorur.

Shembull nga letërsia:

- Letërsia

Përdoret për materiale të përgjithshme të letërsisë. Nëndahet sipas gjuhëve, p.sh.:

Letërsia shqipe; Letërsia angleze, etj.

PP Shkrimet letrare

SGJ Gjuha dhe gjuhë

Shkencat humanitare

Shih edhe emrat e letërsive sipas gjuhës, emrat e vendeve, qyteteve, etj., në nënndarjen Letërsia si dhe subjektet dhe temat në letërsi. P.sh.: Fëmijët në letërsi dhe art; Personazhet dhe veçoritë në letërsi; Realizimi në letërsi; Simbolizmi në letërsi, etj.

SN Arti dhe letërsia

Autorësia

Baladat

Biografia (si formë letrare)

Ditarët

Drama

Esetë
Fabulat
Gazetaria
Humanizmi
Ideologjia dhe letërsia
Kritika
Legjendat
Letërsia fetare
Përrallat me zana
Poezia
Poezia letrare
Satira, etj.

Në formatin MARC:

650 4 |a Letërsi shqipe.

650 4 |a Letërsia shqipe |x Kritika dhe interpretimi.

650 4 |a Letërsia shqipe |x Përmbledhje(Antologjitë) |v Tekste për shkolla të mesme.